DISPOZITA E NGRËNIES SË MISHRAVE në RESTORANTET DHE GJELLËTORET e jobesimtaërve

DISPOZITA E NGRËNIES SË MISHRAVE NË RESTORANTET DHE GJELLËTORET E JOBESIMTARËVE

Shejh Sulejman ibn Nasir el-'Alvan

Pyetje & Përgjigje

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Abdullah Avdyli

REALIZIMI KOMPJUTERIK:
Enter-Design

Muharrem 1447 / Qershor 2025

© Të gjitha drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e kësaj broshure nuk lejohet të riprodhohet nëpërmjet çdo mënyre ose mjeti, qoftë elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin ose çdo lloj mjeti që përdoret për ruajtjen e informacionit, pa lejen paraprake të përkthyesit. Gjithashtu nuk lejohet të shitet apo të shfrytëzohet për ndonjë interes personal.

Gmail: abdullahavdylialb@gmail.com

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

Vëllai ynë pyet në lidhje me dispozitën e ngrënies së mishrave në restorantet dhe gjellëtoret e jobesimtarëve. A duhet pyetur dhe hulumtuar se në çfarë mënyre bëhet therja e kafshëve, apo kjo nuk është e nevojshme?

Për këtë çështje ekzistojnë dy kategori kryesore:

Kategoria e parë: Të therurat e idhujtarëve

Të gjithë dijetarët kanë rënë në ujdi se nuk bën të hahet e therura e idhujtarëve, sepse e therura e tyre nuk lejohet, njësoj siç nuk lejohet e therura e renegatëve (atyre që kanë dezertuar nga feja islame).

Kategoria e dytë: Të therurat e ithtarëve të librit (hebrenjve dhe të krishterëve)

Brenda kësaj kategorie ndahen disa nënkategori (që kërkojnë sqarim më të detajuar):

Nënkategoria e parë:
Nëse kasapi që ther kafshët është laik (domethënë jeton në mesin e ithtarëve të librit, por nuk ndjek asnjërën prej feve të tyre), dhe dihet se ai nuk ndjek asnjërin prej librave të tyre, madje i refuzon tërësisht

fetë e tyre, përfshirë hebraizmin dhe krishterizmin, e therura e tij nuk lejohet të hahet. Allahu ka lejuar të hahet e therura e ithtarëve të librit, por jo edhe e therura e idhujtarëve dhe e atyre që nuk janë prej ithtarëve të librit.

Nëse dikush përkatësohet në hebraizëm apo krishterizëm, e therura e tij lejohet të hahet, edhe pse ai është i humbur dhe ndjek një rrugë të devijuar. Allahu, edhe pse në Librin e Tij i ka përshkruar hebrenjtë dhe të krishterët si idhujtarë, megjithatë ka lejuar të hahet e therura e tyre. Ai thotë:
“Ata i konsideruan “ahbarët” (priftër jehudi) e tyre, “ruhbanët” (murgjit e krishterë) e tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga pejgamberët) pos për adhurimin ndaj Allahut Një, e që nuk ka të adhuruar të vërtetë pos Tij. I Lartë është Ai nga çka i shoqërojnë.”[1]

Pra, edhe pse Allahu i ka përshkruar si idhujtarë, megjithatë ka lejuar të hahet e therura e tyre. Imam Zuhriu ka theksuar se, edhe pse Allahu e ka ditur se ata do të devijojnë, me fjalë dhe vepra të shëmtuara, megjithatë ka lejuar të hahet e therura e tyre. Kështu njësoj ka theksuar edhe Imam Mekhuli.

Nënkategoria e dytë:
Nëse kasapi që ther kafshët është nga ithtarët e librit, si hebre apo i krishterë, atëherë e therura e tij është e lejuar në esencë, me tekst kuranor. Në këtë rast, nuk ka nevojë për pyetje dhe hulumtime të mëtejshme (lidhur me mënyrën e therjes).

Nënkategoria e tretë:
Nëse bëhet e ditur se ithtarët e librit nuk i therin kafshët përmes prerjes në fyt, por i alivanosin me mjete të ndryshme apo i mbysin në ujë, atëherë, sipas shumicës së dijetarëve, nuk lejohet të hahet mishi i kafshëve të therura në këtë mënyrë. Ky qëndrim mbështetet edhe nga Imam Ebu Hanife, Imam Shafiu dhe Imam Ahmedi. Madje, disa dijetarë kanë theksuar se për këtë çështje ekziston konsensus, domethënë të gjithë dijetarët janë të njëjtit mendim.

Mirëpo, në realitet, ky nuk është mendimi i të gjithëve, por vetëm i shumicës (siç u përmend edhe më herët). Prandaj, nuk mund të thuhet se ekziston konsensus për këtë çështje.

Nënkategoria e katërt:
Nëse në një vend banorët i përkasin feve të ndryshme, ku një pjesë janë jobesimtarë të llojit hebre dhe të krishterë, ndërsa një pjesë tjetër janë jobesimtarë të një lloji tjetër (si idhujtarë, laikë, ateistë, etj.), dhe nëse në këtë vend tregtohen dhe shërbehen mishra kafshësh që, me gjasë, mund të jenë therur nga hebrenjtë dhe të krishterët, por prapëseprapë nuk dihet saktësisht nëse janë therur pikërisht nga ata apo nga lloji tjetër i jobesimtarëve, në këtë rast veprohet sipas rregullit për ngrënien e mishit në esencë.

Pra, në esencë, ngrënia e mishit është e lejuar, sipas mendimit më të saktë. Madje, Ibn Tejmije ka theksuar se të gjithë dijetarët klasikë kanë qenë unanimë në këtë qëndrim. Por çështja është se një grup dijetarësh të periudhës mesjetare kanë dalë me një mendim të kundërt, duke pohuar se në esencë ngrënia e mishit është e ndaluar, dhe më pas këtë mendim e ka mbështetur edhe një numër i madh dijetarësh modernë.

Ibn Tejmije gjithashtu ka theksuar se, nëse do të kishte ekzistuar divergjencë mendimesh ndërmjet dijetarëve klasikë lidhur me këtë çështje, ai vetë do të kishte treguar. Por, në fakt, ky mendim i kundërt është

shfaqur më vonë. Ajo që Ibn Tejmije ka sqaruar lidhur me këtë çështje është e saktë: në esencë, ngrënia e mishit është e lejuar, dhe ky qëndrim mbështetet në argumente të qarta nga Kurani dhe Suneti Profetik. Prandaj, mendimi se në esencë ngrënia e mishit është e ndaluar është mendim i pasaktë.

Allahu, në Librin e Tij, thotë:
"...Ai ju sqaroi juve, se çka është e ndaluar për ju..."[2]

Kjo do të thotë se, kur Allahu nuk ka ndaluar diçka, ajo mbetet e lejuar në esencë.

Gjithashtu, thotë:
"Thuaj: Në atë që më është shpallur mua (në Kuran), nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: ngordhësirë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë..."[3]

Ky ajet kuranor tregon qartë se, në esencë, ngrënia e mishit është e lejuar, sepse Allahu i ka thënë Profetit të Tij (ﷺ):
"Thuaj: Në atë që më është shpallur mua (në Kuran), nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi..."

Ato lloje ushqimesh që janë përmendur në ajetin kuranor janë të ndaluara, ndërsa diçka tjetër jashtë tyre nuk është përmendur për ndalesë. Kjo argumenton se, në esencë, ngrënia e mishit është e lejuar.

Dikush ndoshta thotë: "Unë jam i hutuar dhe kam rënë në dyshime për lejueshmërinë e ngrënies së mishit. Nuk e di saktë se kush është kasapi konkretisht, i cili bën therjen e kafshëve, as nëse është e lejuar ngrënia e tij në esencë apo jo", dhe për këtë shkak zgjedh që vetë, personalisht, të përmbahet nga ngrënia e tij (për shkak të dyshimeve që ka). Dakord, kjo është e drejtë e tij personale. Megjithatë, nuk ka të drejtë t'ua ndalojë të tjerëve ta hanë.

Profeti (ﷺ) ka porositur duke thënë:
"Lëre atë që të duket e dyshimtë, dhe merre atë që nuk të duket e dyshimtë!"[4]

Gjithashtu, ai (ﷺ) ka thënë:
"...Ai që ruhet nga gjërat e dyshimta, me këtë veprim ka ruajtur fenë dhe nderin e tij, ndërsa ai që bie në gjërat e dyshimta, si rrjedhojë mund të bie në të ndaluara. Si shembulli i bariut që kopenë e tij kullotë përreth një zone të ndaluar..."[5]

[1] (Et-Teube: 31).

[2] (El-En’am: 119).

[3] (El-En’am: 145).

[4] Transmeton Abdurrezaku në “El-Musannef”, (4984); Ahmedi, 1/200; Tirmidhiu, (2518); Nesaiu, 8/327; Tajalisi, (1178); Darimiu, 2/245; Tabarani në “El-Mu’xhem el-Kebir”, (2708), (2711); Ebu Nu‘ajmi në “Hiljeh el-Evlija”, 8/264; Begaviu në “Sherh es-Sunneh”, (2032). Ibn Hibani e ka klasifikuar si të saktë, (722); po ashtu edhe Hakimi, 2/13, 4/99.

[5] Transmeton Buhariu, (52), (2051); Muslimi, (1599). Ibn Hibani e ka klasifikuar si të saktë, (721).



AbdullahAvdyliALB